



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:282151

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05484624

C.nr.4885/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.M. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.P. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i pagës jubilarë dhe pagave përcjellëse, vlera e kontestit 654.15 euro, jashtë seance, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I.M. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të : ***“DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.M. nga Prizreni, t’ia kompensoj për 30 vjet përvojë pune në vlerë të një page bazë shumë prej 654.15 Euro, të gjitha këto me kamatë ligjore e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë si dhe shpenzimet procedurale, e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.”***

II. Secila palë i bartë vet shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi I.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datë 15.12.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i pagës jubilarë dhe pagave përcjellëse.

Sipas të cekurave në padi, paditësi ka punuar dhe vazhdon të punoj si mësimdhënës pranë Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Pjetër Budi”, në fshati Lubizhdë e Hasit, Komuna e Prizrenit, ku duke u bazuar në vendimin e lëshuar nga drejtoria e shkollës paditësi ka 30 vite të përvojës në punë andaj duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të njëjtit i takon e drejta e kompensimit për paga jubilarë, përkatësisht nenit 35 par.8 pika 3. Andaj i ka propozuar

gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet dhe të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.M. nga Prizreni, t'ia kompensoj për 30 vjet përvojë pune në vlerë të një page bazë shumë prej 654.15 Euro, të gjitha këto me kamatë ligjore e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë si dhe shpenzimet procedurale, e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e pagës jubilarë. E njëjta ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/488, të datës 21.11.2022, për Shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtare e sindikatës. Sipas saj, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: vërtetimin me numër 180/23, të datës 06.06.2023, të lëshuar nga drejtori i SHFMU “Pjetër Budi” në fshatin Lubizhdë e Hasit, Komuna e Prizrenit; Kërkesë drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren me numër 1807/23 të datës 26.09.2023; Përgjigjja nga Drejtoria Komunale e Arsimit, DKA.nr.1829/23, të datës 29.09.2023, dhe lista e pagave në emër të paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK, **gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.**

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 180/23, të datës 06.06.2023 të lëshuar nga drejtori i SHFMU “Pjetër Budi” në fshatin Lubizhdë e Hasit, Komuna e Prizrenit, ka vërtetuar faktin se paditësi I.M. ka qenë në marrëdhënie pune pranë SHFMU “Pjetër Budi” në pozitën e mësimit në mësimdhënës që nga data 01.09.1993 ku ende vazhdon të punoj. I njëjti ka 30 vjet të përvojës në punë.

Nga lista e pagave e cila ndodhet në shkresa të lëndës, gjykata vërtetoi faktin se paga bruto e paditësit I.M. ka qenë në lartësi prej 654.15 euro, ndërsa paga bazë 588.00 €.

Nga kërkesa e paditësit, përkatësisht përgjigjja DKA lidhur me këtë kërkesë, të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësit i është refuzuar kërkesa lidhur me kompensimin e pagave jubilarë me arsyetimin se Kontrata Kolektive nuk ka gjetur zbatueshmëri në Ministrinë e Financave, përkatësisht nuk ka vijë buxhetore për kërkesën e paditësit.

Vërtetimet dhe vendimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë vërtetimi me numër 180/23, të datës 06.06.2023, është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, si e tillë është e pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që provës së lartcekur gjykata ia fali besimin, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me përvojën e punës për këtu paditësin I.M.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me numër të njësisë 01B, numër të prot.2056, të dates 22.02.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës.

Me nenin 35 par.8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër të njësisë 01B, numër të prot.105, të datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit: dhe atë “*për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë; për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë; për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë*” .

Gjykata, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila përcakton se “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija*”.

Gjykata e vlerësoi si të pabazuar kërkesën e paditësit I.M. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që t'ia kompensoi paditësit një pagë në lartësi prej 654.15 Euro, në emër pagës jubilarë për 30 vite të përvojës në punë. Kjo pasi që bazuar në vërtetimin me numër nr.183/23, të datës 06.06.2023, të lëshuar nga e paditura, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pranë të paditurës ka filluar punë me datë 01.09.1993, që i bie se me datë 01.09.2023, i njëjti i ka arritur 30 vjet të përvojës në punë, pra, në kohën kur nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit të datës 22.01.2021, në të cilën paditësi e ka bazuar kërkesën e tij. Kjo duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik me numër 214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ku në pikë III përcaktohet që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e lidhur me datë 22.01.2021, e

nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës, si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datë 21.11.2022.

Andaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e shpërblimin jubilar për 30 vite të përvojës në punë, sepse i njëjti e ka arritur vitin jubilar, në kohën kur nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 450 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, pasi që paditësi e ka humbur kontestin ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar.

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143, lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4885/23/2023, datë 21.03.2024

G j y q t a r j a

Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.